



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.73, datë 24.11.2004

**PËR MIRATIMIN E “RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR MUAJIN
TETOR TË VITIT 2004”**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja “ç” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Raportin e Politikës Monetare për muajin tetor të vitit 2004”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE

PËR MUAJIN TETOR 2004

NËNTOR 2004

Përmbajtja

I.	Zhvillimet kryesore të muajit	4
II.	Ecuria e inflacionit në muajin tetor	5
II.1	Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse	5
II.2	Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit	7
III.	Zhvillimet monetare dhe kërkesa për para	9
III.1	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë	9
III.2	Ecuria e agregatëve monetarë	10
III.3	Kërkesa e ekonomisë për para	12
III.3.1	Mjetet valutore neto	12
III.3.2	Kërkesa e qeverisë për para	12
III.3.3	Kredia për ekonominë nga sistemi bankar	13
IV.	Tregu i parasë dhe normat e interesit	15
IV.1	Ecuria e likuiditetit	15
IV.2	Ecuria e normave të interesit	15
IV.3	Kursi i këmbimit	18

I. ZHVILLIMET KRYESORE TË MUAJIT

Inflacioni vjetor shënoi 2.0 për qind në muajin tetor duke qenë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni mesatar vjetor ishte 3.1 për qind. Inflacioni mujor në muajin tetor ishte 0.23 për qind.

Faktorët e kërkesës nuk kanë ushtruar presione inflacioniste gjatë muajit tetor. Efekti i rënies sezonale të çmimeve të mallrave ushqimorë ka vazhduar të jetë i pranishëm, duke balancuar inflacionin vjetor të shkaktuar nga rritja e çmimit të energjisë elektrike në fillim të këtij viti.

Rritja e çmimit ndërkombëtar të naftës nuk ka ndikuar dukshëm në inflacion, kryesisht si pasojë e mbiçmimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me politikën e saj monetare, uli me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në datën 11 nëntor. Politika lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka sjellë reduktimin e mëtejshëm të interesave të depozitave në lekë, të tregut primar dhe të atij ndërbankar. Përgjithësisht, gjatë vitit 2004, vihet re një reagim i shpejtë i bankave ndaj sinjaleve të politikës monetare.

Rritja vjetore e ofertës monetare është stabilizuar në nivelin 9.9 për qind në muajin shtator, pas përshpejtimit të shënuar gjatë muajve të verës. Kontributin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit shtator e kanë dhënë depozitat në lekë.

Pozicioni valutor i sistemit bankar është përmirësuar gjatë muajit shtator. Gjatë këtij muaji është shënuar një rritje prej 31.5 milionë dollarësh në nivelin e mjeteve valutore neto.

Deficiti buxhetor është mbuluar tërësisht nga financimi i brendshëm gjatë muajit shtator. Sistemi bankar ka vazhduar të financojë qeverinë duke blerë bono thesari dhe obligacione qeveritare.

Kredia për ekonominë ka shënuar rritje të kënaqshme gjatë vitit, ndërkohë që është vënë re një zhvendosje e portofolit drejt afateve më të gjata të maturimit. Megjithatë, rritja e tepricës së kredisë për ekonominë shënoi një ngadalësim në muajin shtator, pjesërisht e ndikuar edhe nga efekti i kursit të këmbimit.

Ndërkohë, kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros, gjatë periudhës shtator-tetor, ka qenë në përgjithësi i qëndrueshëm, mesatarisht 125.4 lekë/euro. Leku ka vijuar të mbiçmohet kundrejt dollarit amerikan, duke reflektuar dobësimin e dollarit në tregjet botërore.

II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN TETOR

II.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE

Norma vjetore e inflacionit, në muajin tetor 2004, rezultoi 2.0 për qind, duke qenë brenda intervalit objektiv 2 - 4 për qind. Ndërkohë, inflacioni mesatar vjetor mbeti në të njëjtin nivel të muajit paraardhës, 3.1 për qind. Zhvillimet pozitive në çmimet e konsumit kanë vijuar të mbështeten nga situata e favorshme makroekonomike dhe nga politika monetare dhe fiskale e kujdesshme.


Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	2.9
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	3.1
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	2.7
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	2.0
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	2.0
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
Mesatar	0.1	3.1	5.2	2.2	3.1

Burimi: INSTAT.

Prodhimi i bollshëm bujqësor i këtij viti, ka sjellë uljen e çmimeve të mallrave ushqimorë dhe ka përcaktuar në një masë të konsiderueshme edhe ecurinë në ulje të inflacionit vjetor, që prej muajit maj 2004. Në përputhje me ecurinë sezonale, inflacioni mujor shënoi një vlerë pozitive prej 0.23 për qind në muajin tetor, por ajo ishte më e ulët se norma 2.8 për qind e inflacionit mujor gjatë muajit tetor 2003.


Grafik 1. Inflacioni vjetor (në për qind).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit tetor është regjistruar rritje vjetore në çmimet e pothuajse të gjitha grupeve të shportës së konsumit me përjashtim të grupit “Ushqim dhe pije joalkolike”. Rritja më e madhe dhe kontributi më i madh në normën vjetore të inflacionit është dhënë nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”, i cili është shfaqur si grupi me inflacionin më të lartë vjetor që prej muajit shkurt të këtij viti, menjëherë pas rritjes së çmimit të administruar të energjisë. Ky grup kontribuoi me 2.24 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit, gjatë muajit tetor. Pritet që efekti i rritjes së çmimit të energjisë elektrike të jetë i ndjeshëm, të paktën deri në tremujorin e parë të vitit 2005.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Kontributi i ndjeshëm në inflacionin vjetor i inflacionit të grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” është balancuar nga rënia në çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkolike”. Grupi ushqimor ka shfaqur rënie të ndjeshme të çmimeve, duke filluar që nga muaji maj i këtij viti. Rënia e çmimeve të mallrave bujqësorë, e cila është ndjerë edhe në muajin tetor, është tregues i një prodhimi të bollshëm bujqësor. Norma negative e inflacionit vjetor të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” prej - 2.2 për qind e ka ulur normën vjetore të inflacionit me rreth 1 pikë përqindjeje. Rritja mujore e çmimeve të mallrave ushqimorë ka qenë mjaft e vogël (0.3 për qind). Inflacioni vjetor i këtij grupi ka shënuar një kthesë të tendencës në krahasim me muajin tetor të vitit të kaluar, kur inflacioni vjetor shënoi 4.3 për qind. Arsyeja pas kësaj rënieje është kryesisht ulja e çmimeve të produkteve sezonale si frutat dhe perimet.

Tabelë 2. Norma mujore dhe vjetore e grupit “Ushqim dhe pije alkolike”.

	"Ushqim dhe pije joalkolike"		Nëngrupi "Fruta"		Nëngrupi "Zarzavate"	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Tetor '04	0.3	-2.2	-1.3	-1.2	3.4	-18.1
Tetor '03	-0.5	4.3	3.1	24.8	-6.1	14.6


Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Rreziku i rritjes së çmimit të naftës në vend dhe përçimi i kësaj rritjeje në koston e mallrave të tjerë, nuk u vërtetua as në zhvillimet e këtij muaji. Rritja e inflacionit të grupit “Transport” në 3.9 për qind dha një kontribut modest prej vetëm 0.2 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor. Ndikimi i këtij grupi mbetet i dobët, jo vetëm për shkak të peshës së vogël që ky grup zë në shportën e mallrave të IÇK-së, por dhe për shkak të mbiçmimit të monedhës sonë ndaj dollarit¹ (monedhë në të cilën importohet nafta), i cili ka bërë që rritja e çmimit në dollarë të naftës, të transmetohej vetëm pjesërisht në çmimin e shprehur në lek.

¹ Në muajin tetor monedha jonë u mbiçmua ndaj dollarit me 1.8 për qind ndaj shtatorit dhe 13.5 për qind ndaj tetorit të vitit të kaluar.

Grupet e tjera si “Shërbimi arsimor” (11.4%)², “Hotele, kafene, restorante” (3.6%), “Komunikimi” (15.5%)² dhe “Veshje dhe këpucë” (-2.0%)² dhanë një kontribut prej 0.5 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit të muajit tetor.

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

II.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Inflacioni vjetor ka qëndruar brenda intervalit të synuar nga Banka e Shqipërisë prej 2 – 4 për qind, për të gjashtin muaj radhazi. Plotësimi i nevojave për mallra ushqimorë nga oferta e brendshme u shoqërua me uljen e importeve³ të këtyre mallrave (të shprehura në lek), duke ulur ndikimin e inflacionit të importuar në inflacionin në vend. Për më tepër, vendet kryesore partnere në tregtinë e jashtme kanë shënuar norma të moderuara inflacioni.

Tabelë 3. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).

	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Greqi	2.6	2.9	3.1	3.1	3.0	3.1	2.8	2.9
Itali	2.4	2.3	2.3	2.3	2.4	2.2	2.4	2.1

Burimi: Eurostat News Release.

Nga ana tjetër, leku e ka filluar tremujorin e katërt duke fituar pikë kundrejt euros dhe dollarit. Gjatë periudhës shtator-tetor, leku është mbiçmuar mesatarisht ndaj euros dhe dollarit përkatësisht me 8.0 dhe 14.0 për qind. Tendenca mbiçmuese e lekut ka shërbyer si zbutëse e presioneve inflacioniste, që vijnë nga inflacioni i importuar i mallrave të konsumit (përfshirë naftën).


Banka e Shqipërisë ka krijuar një ambient të përshtatshëm monetar për kontrollin e inflacionit. Megjithatë politika monetare ka ruajtur kahun e saj zbutës, uljet e vazhdueshme të normës së interesit nuk duken të kenë ndikuar në ekuilibrat makroekonomikë. Situata e kënaqshme e likuiditetit, norma vjetore e rritjes së M1 nën nivelet historike, kthimi i parasë jashtë bankave në

² Shifrat në kllapa tregojnë inflacionin vjetor për muajin tetor të grupit përkatës.

³ Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004.

sistem dhe rrjedhimisht, rritja e depozitave në lekë janë tregues pozitivë të një politike monetare të favorshme për mbajtjen brenda intervalit objektiv të normës së inflacionit.

Grafik 4. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Treguesit fiskalë kanë respektuar nivelet e programuara. Deri në fund të muajit shtator, qeveria ka treguar kujdes me shpenzimet buxhetore duke realizuar rreth 90.5 për qind të shpenzimeve të planifikuara për nëntëmujorin e parë ose 67 për qind të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2004. Kujdesi i treguar në këtë drejtim ka bërë që presionet inflacioniste të mos jenë të pranishme për tremujorin e tretë dhe për muajin në vazhdim.


III. ZHVILLIMET MONETARE DHE KËRKESA PËR PARA

III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Përmirësimi i vazhdueshëm i stabilitetit makroekonomik dhe kushtet e qëndrueshme monetare, kanë mundësuar ndjekjen e një politike monetare zbutëse gjatë dy viteve të fundit. Rritja ekonomike ka ndjekur ecurinë e parashikuar ndërkohë që inflacioni ka qenë i moderuar, duke ruajtur norma reale interesi pozitive. Niveli i normave reale të interesit ka kontribuar në ruajtjen e ekuilibrave monetarë dhe në garantimin e një situatë të qëndrueshme likuiditeti në sistem. Në këto kushte, politika monetare zbutëse ka synuar nxitjen e mëtejshme të aktivitetit ekonomik, nëpërmjet uljes së kostos së huamarrjes, si dhe zbutjen e presioneve mbiçmuese të kursit të këmbimit të lekut. Ulja e vazhdueshme e normës bazë të interesit është shoqëruar me reduktimin e normave të interesit të depozitave, të kredive dhe të bonove të thesarit në lekë.

Tremujori i tretë i vitit u karakterizua nga presione të ulëta inflacioniste dhe nga një situatë relativisht e qetë likuiditeti në tregun ndërbankar. Në përputhje me pritshmëritë sezonale, prodhimi bujqësor dhe hyrjet valutore shënuan rritje të ndjeshme gjatë kësaj periudhe. Këta faktorë ndikuan në uljen e mëtejshme të presioneve inflacioniste në këtë tremujor. Për rrjedhojë, inflacioni shënoi ulje gjatë tre muajve të fundit, duke arritur në kufirin e poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, rritja e ofertës së valutës në treg dhe reduktimi i kërkesës për të si pasojë e reduktimit të importeve, rritën presionet për mbiçmimin e lekut. Duke ndjekur vazhdimisht ecurinë e inflacionit dhe të kushteve monetare, Banka e Shqipërisë ndërmori një uje tjetër të normës bazë të interesit në datën 11 nëntor. Ky reduktim, i pesti gjatë vitit 2004, e ka zbritur nivelin e normës bazë të interesit nga 8.5 për qind, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2002, në 5.25 për qind.

Grafik 5. Ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor gjatë muajit gusht, në kahun e blerjes së valutës, duke injektuar likuiditet dhe duke kompensuar kërkesën e ulët për valutë. Qetësimi i presioneve mbiçmuese në muajt në vijim nuk e ka bërë të nevojshme praninë e Bankës së Shqipërisë në këtë treg.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të tërheqë likuiditet nga sistemi, duke përdorur instrumentin e marrëveshjeve të riblerjes gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, ajo ka respektuar objektivat e saj sasiorë, në kuadrin e marrëveshjes PRGF.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.


	Dhjetor '03	Mars 04	Qershor 04	Gusht'04	Shtator '04
Rezerva ndërkombëtare neto (në milionë dollarë)					
Objektivi	715.8	751.8	765.8	871.1	923.7
Aktuale	832.7	827.6	961.5	1041.9	1043.6
Diferenca	116.8	75.8	195.7	170.9	119.9
Mjetet e brendshme neto (në miliardë lekë)					
Objektivi	96.0	83.0	85.0	75.0	70.0
Aktuale	72.0	66.4	54.7	59.5	55.4
Diferenca	-24.0	-16.6	-30.3	-15.5	-14.5
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)					
Objektivi	280.9	272.8	270.1	276.1	279.1
Aktuale	266.8	272.6	263.6	268.3	272.0
Diferenca	0.0	-0.2	-6.5	-7.8	-7.1

Burimi: Banka e Shqipërisë

III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Përshpejtimi i rritjes së ofertës monetare gjatë muajve të verës është pasuar nga stabilizimi i saj në muajin shtator. Norma vjetore e rritjes së agregatit M3 rezultoi 9.9 për qind, duke mbetur pothuajse e pandryshuar nga niveli i një muaji më parë. Kjo ecuri ka reflektuar kërkesën e qëndrueshme të qeverisë dhe të ekonomisë për para, dhe mosndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, ndërkohë që mbiçmimi i lekut ka ndikuar negativisht rritjen e depozitave në valutë. Paraja jashtë bankave ka vijuar kthimin e saj në sistem me ritëm të kënaqshëm, duke ndihmuar në rritjen e depozitave në lekë dhe zhvendosjen e strukturës kohore të ofertës monetare drejt mjeteve më pak likuide.

Grafik 6. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta monetare gjatë muajit shtator ka shënuar një rritje prej 2.5 miliardë lekësh ose rreth 0.5 për qind. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë depozitat në lekë, të cilat kanë pësuar një rritje mujore me 4.3 miliardë lekë, ndërkohë që niveli i parasë jashtë bankave është ulur me 2.6 miliardë lekë. Depozitat në valutë paraqiten me një rritje prej 0.8 miliardë lekësh.

Rënia e kërkesës për para fizike, me përfundimin e sezonit të verës është shoqëruar me rikthimin e shpejtë të saj në sistem. Ky kthim është mbështetur nga nivelet e kënaqshme të normave reale të interesit për depozitat në lekë, si rezultat i rënies së normës së inflacionit. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në muajin shtator, zbriti në 25.9 për qind duke shënuar një rënie me 0.7 pikë përqindjeje krahasuar me muajin e kaluar. Pas ecurisë në rritje të parasë jashtë bankave gjatë muajve të fundit, norma vjetore e rritjes së këtij treguesi në muajin shtator shënoi rënie, duke u ulur në 4.1 për qind, nga 5.5 për qind që

ishite në muajin gusht. Kjo ecuri e saj ka përcaktuar edhe ngadalësimin e rritjes së normës vjetore të agregatit M1, e cila rezultoi e pandryshuar në nivelin 8.8 për qind, duke mbetur nën nivelet historike.

Grafik 7. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Norma vjetore e rritjes së depozitave në lekë arriti në 12.1 për qind, nga 11.5 që ishte një muaj më parë, në përputhje me tendencën rritëse të muajve të fundit. Rritja e tyre ka qenë kryesisht në formën e depozitave pa afat në lekë, të cilat në muajin shtator shënuan një rritje prej 2.7 miliardë lekësh. Normat vjetore të rritjes së depozitave me afat në lekë paraqiten të qëndrueshme dhe në nivele të kënaqshme. Megjithëse diferenca midis normave të interesit në lekë dhe atyre në valutë ka qenë lehtësisht në rënie, rritja e besimit në valutën vendase ka vazhduar të favorizojë instrumentet e investimit në lekë. Prania e këtij faktori vihet re edhe në rritjen e interesimit për të investuar në bono thesari nga ana e individëve, portofoli i të cilëve vetëm në muajin shtator është rritur me 0.8 miliardë lekë.

Norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë në muajin shtator rezultoi në 12.1 për qind, duke qenë në linjë me normat vjetore të këtij treguesi të shfaqura në muajt e fundit. Mbiçmimi i lekut kryesisht ndaj dollarit amerikan gjatë muajit shtator, ka ndikuar negativisht rritjen e depozitave në valutë, me rreth 1.8 miliardë lekë. Në mungesë të efektit negativ të mbiçmimit vjetor të kursit të këmbimit, efekt i cili vlerësohet rreth 13.9 miliardë lekë, norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë do të ishte e qëndrueshme në 25.5 për qind. Ecuria e strukturës kohore të depozitave në valutë paraqet një zhvendosje drejt depozitave me afat, duke reflektuar rritjen graduale të interesave për depozitat me afat në usd gjatë muajve të fundit. Në muajin shtator raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare arriti në 23.7 për qind. Ky nivel shënon një rritje të lehtë kundrejt muajit të kaluar dhe përputhet me tendencën afatgjatë rritëse të këtij treguesi.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin shtator (në miliardë lekë).

	Shtator 2004	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
		Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	126.2	-2.6	-2.0	4.9	4.1
Depozitat totale	361.3	5.1	1.4	39.0	12.1
- në lekë	245.6	4.3	1.8	26.5	12.1
- në valutë	115.8	0.8	0.7	12.5	12.1
Depozita pa afat	72.4	1.6	2.3	11.4	18.7
- në lekë	27.8	2.7	10.8	7.5	37.1
- në valutë	44.6	-1.1	-2.4	3.9	9.6
Depozita me afat	288.9	3.5	1.2	27.6	10.5
- në lekë	217.8	1.6	0.7	19.0	9.5
- në valutë	71.2	1.9	2.7	8.6	13.7

M1	154.0	0.1	0.1	12.4	8.8
M2	371.8	1.7	0.5	31.4	9.2
M3	487.6	2.5	0.5	43.9	9.9
Baza monetare	166.5	-3.9	-2.3	9.3	5.9

Burimi: Banka e Shqipërisë


III.3 KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

III.3.1 Mjetet valutore neto

Pozicioni valutor i sistemit bankar është përmirësuar gjatë muajit shtator. Gjatë këtij muaji është shënuar një rritje prej 31.5 milionë dollarësh në nivelin e mjeteve valutore neto. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja e mjeteve valutore neto do të ishte rreth 14 milionë dollarë. Rritja e mjeteve valutore neto në muajin shtator ka dhënë një kontribut prej 63.3 për qind në rritjen e agregatit M3.

Kontributin më të madh në rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar e kanë dhënë bankat e nivelit të dytë. Rritja e depozitave në valutë ka qenë më e lartë se kërkesa e ekonomisë për kreditim në valutë gjatë muajit shtator. Për pasojë, mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë janë rritur me rreth 17 milionë dollarë. Banka e Shqipërisë ka vazhduar të rrisë gjithashtu nivelin e rezervës valutore neto. Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 14.4 milionë dollarë gjatë muajit shtator. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje është shkaktuar nga mbiçmimi me 1.9 për qind të euros ndaj dollarit në tregun ndërkombëtar. Ky mbiçmim ka rritur vlerën e investimeve në euro të shprehura në dollarë amerikanë. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë është 3.5 milionë dollarë. Gjithashtu, edhe prania e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor në kahun e blerjes së valutës ka ndikuar në rritjen e rezervës valutore.

Grafik 8. Mjetet valutore të sistemit bankar (në milionë usd).




Burimi: Banka e Shqipërisë

III.3.2 Kërkesa e qeverisë për para

Qeveria ka rritur kërkesën për mjete monetare në muajin shtator. Krahasuar me një muaj më parë, deficitin buxhetor është rritur me 2 miliardë lekë duke arritur nivelin 13.7 miliardë lekë.

Grafik 9. Financimi i deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Këtë muaj, kjo kërkesë e qeverisë është mbuluar tërësisht nga financimi i brendshëm, i cili ishte rreth 2.9 miliardë lekë. Sistemi bankar ka vazhduar të financojë qeverinë duke blerë bono thesari dhe obligacione qeveritare. Në ndryshim nga tre muajt paraardhës, bankat e nivelit të dytë kanë rritur portofolin e tyre të bonove të thesarit. Kjo rritje është në nivelin 4.6 miliardë lekë. Institucionet kanë vazhduar të pakësojnë portofolin e bonove të thesarit (me 1 miliard lekë), ndërsa Banka e Shqipërisë dhe individët i kanë rritur lehtësisht portofolet e tyre. Në muajin shtator janë emetuar 1 miliard lekë obligacione qeveritare. Edhe këtë muaj, për llogari të qeverisë, kanë kaluar një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve, rreth 0.1 miliardë lekë.

III.3.3 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Aktiviteti kreditues i sistemit bankar ka njohur zhvillime pozitive gjatë vitit 2004. Kredia për ekonominë ka shënuar rritje të kënaqshme gjatë vitit, ndërkohë që është vënë re një zhvendosje e portofolit drejt afateve më të gjata të maturimit. Megjithatë, rritja e tepricës së kredisë për ekonominë shënoi një ngadalësim në muajin shtator, pjesërisht e ndikuar edhe nga efekti i kursit të këmbimit. Kështu, teprica e kredisë, në muajin shtator, qëndroi në të njëjtin nivel me muajin paraardhës, 60.9 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë mbeti në nivelin 10.2 miliardë lekë, duke përbërë rreth 87 për qind të rritjes së parashikuar në programin monetar. Në mungesë të mbiçmimit të lekut kundrejt valutave kryesore, rritja mujore e tepricës së kredisë do të kishte qenë në nivelin 0.75 miliardë lekë. Po ky mbiçmim jep një efekt negativ prej 3.1 miliardë lekësh në rritjen e kredisë gjatë vitit 2004.

Tabelë 6. Ecuria e disa treguesve kryesorë⁴.

	2002	2003	2004				
			T-1	T-2	Korrik	Gusht	Shtat.
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	456.0	458.2	469.9	485.1	487.6
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	71.6	69.5	69.1	66.9	67.4
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	59.9	57.1	56.3	54.3	54.8
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	11.7	12.4	12.8	12.6	12.6
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	13.7	14.6	15.1	15.0	14.7
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	7.0	7.4	7.2	7.3	7.3
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	44.1	41.3	42.6	44.4
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	15.8	16.7	17.4	17.1	16.9

Burimi: Banka e Shqipërisë

⁴ Ky raport është ndërtuar ndaj PBB në nivel vjetor për vitin 2004.

Struktura e kredisë sipas afateve tregon për një rritje të mëtejshme të peshës së kredisë afatmesme dhe afatgjatë në totalin e kredisë gjatë muajit shtator. Kjo rritje duhet konsideruar si një zhvillim pozitiv, pasi i përgjigjet më mirë nevojave të vendit për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve podhuese. Nga ana tjetër, edhe kredia në lekë shënoi rritje ndaj totalit të kredisë, donëse ajo vazhdon të mbetet në nivele modeste.

Tabelë 7. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë, në përqindje.

	2002	2003	T-1 '04	T-2' 04	Korrik '04	Gusht '04	Shtator'04
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.8	60.0	60.9	60.9
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	35.4	35.6	35.0	34.0
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.8	37.4	38.0	37.0
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	26.8	27.0	27.0	29.0
Lekë	21.3	19.6	17.0	17.0	16.0	16.0	17.0
Valutë	73.7	80.4	83.0	83.0	84.0	84.0	83.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit shtator janë lëvruar 5.7 miliardë lekë kredi të reja ose rreth 25 për qind më shumë se një muaj më parë. Kredia e re, e lëvruar gjatë nëntë muajve të parë të vitit, arriti në 74.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 17 për qind më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në përgjithësi, lëvrimi i kredive të reja si mbi bazë mujore ashtu edhe në trajtë kumulative, është karakterizuar nga tendenca rritëse nga muaji në muaj, në krahasim me vitin e kaluar.

Kredia afatmesme dhe afatgjatë përbën 42 për qind të kredisë së re të lëvruar gjatë muajit shtator. Muaji shtator ka shënuar një zhvillim pozitiv për sa i përket strukturës vakutore të kredisë së re të akorduar. Gjatë këtij muaji, kredia e re në lekë ka përbërë 39 për qind të totalit të kredisë së re, duke qenë 6 pikë përqindjeje më e lartë se një muaj më parë dhe mjaft më e lartë në krahasim me nivelet historike prej 25 për qind.

Tabelë 8. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).

	2002	2003	T-1 '04	T-2'04	T-3 '04
Kredi e re (në mld lekë)	62.6	92.6	27.9	28.5	18.0
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	18.7	18.1	10.9
Kredi afatmesme	13.0	22.2	5.7	6.8	3.9
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	3.5	3.6	3.1
Lekë	20.8	30.8	8.80	8.9	6.0
Valutë	41.8	61.8	19.10	19.6	12.0


Burimi: Banka e Shqipërisë

IV. TREGU I PARASË DHE NORMAT E INTERESIT

IV.1 ECURIA E LIKUIDITETIT

Sistemi bankar është karakterizuar nga tepërcë likuiditeti në nivele të qëndrueshme gjatë muajit tetor. Niveli mesatar i likuiditetit shënoi vlerën 4.3 miliardë lekë, duke rezultuar 1 miliard lekë nën mesataren e muajit shtator. Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar, gjatë muajit tetor është ndikuar kryesisht nga rritja e kërkesës së qeverisë për financimin e deficitit buxhetor në këtë periudhë.

Grafik 10. Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar (në milionë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Për tërheqjen e likuiditetit të tepërt, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e repos njëjavore me çmim fiks. Shuma e investuar në repo, gjatë muajit tetor, rezultoi mesatarisht 3.9 miliardë lekë, ose 1.4 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë. Niveli më i lartë i likuiditetit që u shënuar në muajin shtator, u reflektua në rritjen e depozitave njëditore, si pasojë e organizimit të ankandëve të repos me shumë të kufizuar.

Në muajin tetor, likuiditeti i tërhequr me anë të depozitës njëditore ka rezultuar në nivele më të ulëta se një muaj më parë. Në depozitë njëditore janë investuar mesatarisht 0.4 miliardë lekë ose 1.5 miliardë lekë më pak. Kredia njëditore është lëvruar mesatarisht në vlerën 0.66 miliardë lekë. Kërkesa për likuiditet rezultoi nga sjellja e bankave të veçanta, ndërkohë që aktiviteti i tregut ndërbankar ka shënuar rritje. Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve, në muajin tetor, regjistroi 0.3 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë.

Kërkesa e qeverisë për financim është përballuar nga sistemi bankar dhe nga individët. Oferta e bankave për të investuar në bono thesari të qeverisë ka qenë më e lartë sesa kërkesa e qeverisë dhe e përqendruar në bonot e thesarit për afate gjashtëmuajore e dymbëdhjetëmuajore. Kjo ka çuar në rritjen e konkurrencës për to dhe në uljen e yield-it përkatës.

IV.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Politika lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka sjellë reduktimin e mëtejshëm të interesave të depozitave në lekë, të tregut primar dhe të atij ndërbankar. Normat e interesit pritet të vijojnë të ulen, në përgjigje të uljes së normës bazë të interesit në fillim të muajit nëntor. Në fund të muajit shtator, interesat mesatarë të ponderuar për depozitat tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmuajore në lekë, kanë arritur përkatësisht në nivelet 4.83 për qind, 5.79 për qind dhe 6.26 për qind.

Tabelë 9. Reagimi i sistemit bankar ndaj politikës monetare gjatë vitit 2004 (në pikë përqindjeje).


	30/12-28/04	28/4-25/06	25/06-28/07	28/07-29/10	29/10-11/11	Total
Ulja e normës bazë të int.	-0.25	-0.25	-0.25	-0.25	-0.25	-1.25
Depozita në lekë						
3 mujore	-0.43	-0.31	-0.02	-0.20	-0.09	-1.05
6 mujore	-0.53	-0.51	-0.02	-0.51	-0.04	-1.61
12 mujore	-0.50	-0.58	0.00	-0.49	-0.04	-1.61
Yield-i i bonove të thesarit						
3 mujore	-0.30	-0.26	0.02	-0.47	-0.16	-1.17
6 mujore	-0.4	-0.17	-0.08	-0.78	-0.03	-1.46
12 mujore	-0.3	-0.22	-0.1	-0.63	-0.13	-1.38

Sipas të dhënave operative.

Burimi: Banka e Shqipërisë

Pas uljes së fundit të normës bazë të interesit, kanë filluar dhe reagimet e para nga bankat për uljen e interesave të depozitave në lekë, e cila pritet të reflektohet dhe në ditët në vijim. Përgjithësisht, gjatë vitit 2004, vihet re një reagim i shpejtë i bankave ndaj sinjaleve të politikës monetare. Ulja më e ndjeshme e normës së interesave vihet re në depozitat gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore, duke reflektuar deri-diku pritshmëritë e tregut për ulje të mëtejshme të tyre. Pavarësisht kësaj tendence, si pasojë e inflacionit të ulët, norma e interesit real të depozitave në lekë është rritur duke shtuar vlerën e kursimeve të depozituesve.


Grafik 11. Interesat realë dhe nominalë të depozitave me afat 12-mujor në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Nivelet e ulëta të yield-it të bonove të thesarit, kanë ndikuar në uljen e kostos së borxhit të brendshëm të qeverisë. Në tregun primar, yield-i mesatar i ponderuar i bonove të thesarit me maturitet tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujor zbriti përkatësisht në 6.21 për qind, në 7.28 për qind dhe në 8.14 për qind. Pavarësisht reagimit të ndryshëm në kohë dhe në madhësi, vërehet një qëndrueshmëri dhe stabilitet i spread-it midis yield-it të bonove të thesarit dhe interesit të depozitave në lekë, kryesisht pas tremujorit të parë të vitit 2003.


Grafik 12. Ecuria e yield-it të bonove të thesarit.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Tregu ndërbankar është karakterizuar nga luhatjet e normave të interesit, por tendenca e përgjithshme, në fund të muajit tetor, ka qenë rënëse. Në javën e parë të muajit nëntor, interesat e transaksioneve një dhe shtatë ditore, arritën përkatësisht në nivelet 2.96 për qind dhe 5.78 për qind.

Grafik 13. Normat e interesit për transaksionet njëditore.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin shtator, interesat e kredive në lekë për të gjitha afatet kanë shënuar ulje krahasuar me një muaj më parë, duke reaguuar në të njëjtin kah me sinjalet e politikës monetare. Megjithatë, gjatë vitit 2004 është vënë re një zhvendosje e kredisë drejt afateve më të gjata të maturimit, zhvendosje e cila ka ndikuar në rritjen e normës mesatare të ponderuar të interesit.

Tabelë 10. Normat e interesit për kreditë në lekë (në përqindje).


	Gusht-04	Shtator-04	Ndryshimi
Kredi deri 6 muaj	11.27	11.20	-0.07
Kredi 6muaj -1vit	18.57	15.02	-3.55
Kredi 1-3 vjet	22.97	22.29	-0.68
Kredi mbi 3 vjet	14.94	14.56	-0.38

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tregu i depozitave në valutë ka shënuar rritje të interesave në usd, të cilat kanë arritur në nivelet më të larta gjatë vitit 2004. Spread-i i interesave të depozitave në lek me ato në usd

ka rënë në 4.0 për qind, ndërkohë që spread-i i interesave të depozitave në lekë me ato në euro ka zbritur në 3.6 për qind.

Grafik 14. Interesat mesatarë të ponderuar të depozitave në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në ndryshimin e normës së interesit në usd, ka ndikuar rritja e interesave libor në tregjet ndërkombëtare në nivelet më të larta të vitit, si pasojë e shtrëngimit të politikës monetare nga Fed-i. Ndërkohë, një rënie të lehtë kanë pësuar interesat e depozitave në euro, ndikuar nga rënia e lehtë e interesave euribor. Në muajin shtator⁵, interesat mesatarë të ponderuar të depozitave me afat në usd dhe euro, arritën përkatësisht në 1.15 për qind dhe 1.6 për qind.

Në përgjigje të ndryshimit të interesave të depozitave në valutë dhe të nivelit të interesave libor e euribor në tregjet ndërkombëtare, bankat kanë rritur interesat e kredive, në usd mesatarisht me 0.67 pikë përqindjeje dhe kanë ulur ato në euro me 0.57 pikë përqindjeje. Në muajin shtator, interesi mesatar i kredive në usd arriti në 8.48 për qind dhe ai në euro në 8.56 për qind.


IV.3 KURSI I KËMBIMIT

Leku ka vijuar të mbiçmohet kundrejt dollarit amerikan gjatë muajit të fundit. Në dhjetëditëshin e parë të muajit nëntor, kursi i këmbimit të lekut kundrejt usd arriti në 98.4 lekë/usd. Ndërkohë, kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros, gjatë periudhës shtator-tetor, ka qenë në përgjithësi stabil – mesatarisht 125.4 lekë/euro - me një tendencë të lehtë nënçmimi të lekut në fund të tetorit. Kjo tendencë është bërë më e dukshme në fillim të nëntorit, kur leku është luhatur rreth nivelit 127.2 lek/euro.

Ndikimin më të madh në ecurinë e kursit të këmbimit të dollarit amerikan e ka patur faktori i jashtëm. Në tregjet ndërkombëtare, shkëmbimi i euros në raport me monedhën amerikane arriti nivelet më të larta historike, 1.299 dollarë/euro, gjë që u reflektua dhe në tregun tonë valutor.

⁵ Sipas të dhënave operative në nëntor, interesat mesatarë të ponderuar për depozitat me afat në usd arritën në 1.19% dhe në euro 1.61%.

Grafik 15. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut kundrejt usd dhe euros.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Forcimi i lekut ndaj valutave, gjatë muajve të fundit, ka rezultuar dhe nga faktorë të ekonomisë shqiptare. Rritja e prodhimit të brendshëm bujqësor ka ndikuar në uljen e importeve për këto produkte e si rrjedhim, në uljen e kërkesës për valutë. Niveli i ulët i inflacionit ka ruajtur interesin real për lekun në nivel të favorshëm për ta bërë këtë monedhë më të preferuar kundrejt të tjerave. Për më tepër, diferenca pozitive e kënaqshme midis normës së interesave në lekë dhe atyre në valutë ka ruajtur të lartë kërkesën për monedhën vendase.

* * *



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.74, datë 24.11. 2004

**PËR ZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E ZËVENDËSGUVERNATORËVE
TË BANKËS SË SHQIPËRISË.**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë dhe të emërojë në funksionin e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë z. Fatos Ibrahimimi.
2. Të zgjedhë dhe të emërojë në funksionin e Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë z. Limos Malaj.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.75, datë 24.11.2004

**PËR MIRATIMIN E EMËRIMIT TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË
BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË.**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja (h) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të emërojë në funksionin e Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik të Bankës së Shqipërisë z. Dashamir Halilaj.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr.01, datë 28.01.2004 Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01.2004 Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr.75, datë 25.09.2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004 Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SËIFT” miratuar me vendimin nr.16, datë 01.03.2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01.2004 Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr.06, datë 11.02.2004 Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr.07, datë 11.02.2004 Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr.08, datë 25.02.2004 Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004 Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr.10, datë 25.02.2004 Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr.12, datë 25.02.2004 “Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004 Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo- Shqiptare”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr.16, datë 10.03.2004 Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.

2. Vendim nr.17, datë 10.03.2004 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr.20, datë 24.03.2004 Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.

2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr.57, date 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr.40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004 Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.

4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004 Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Prill 2004

1. Vendim nr.26, datë 14.04.2004 Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve.

2. Vendim nr.27 datë 14.04.2004 “Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004

1. Vendim nr.28, datë 28.04.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.

2. Vendim nr.29, datë 28.04.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”.

3. Vendim nr.30, datë 28.04.2004 Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.

4. Vendim nr.31, datë 28.04.2004 Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004

1. Vendim nr.35, datë 12.05.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004

1. Vendim nr.36, datë 26.05.2004 Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.

2. Vendim nr.37, datë 26.05.2004 Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 përqind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.

3. Vendim nr.38, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.

4. Vendim nr.39, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004

1. Vendim nr.46, datë 09.06.2004 Për “Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Qershor 2004

1. Vendim nr.47, datë 18.06.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004”.

2. Vendim nr.48, datë 18.06.2004 “Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Qershor 2004

1. Vendim nr.50, datë 23.06.2004 “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

2. Vendim nr.51, datë 23.06.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004

1. Vendim nr.52, datë 14.07.2004 Për “Administrimin e rrezikut të kredisë”.
2. Vendim nr.53, date 14.07.2004 Për “Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 14, Korrik 2004

1. Vendim nr.56, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.57, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
3. Vendim nr.58, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri””.
4. Vendim nr.59, datë 28.07.2004 Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 15, Gusht 2004

1. Vendim, nr.60, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2004”.
2. Vendim nr.61, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e transferimit të pronësisë së 100 përqind të aksioneve të kapitalit aksioner të bankës së kursimeve sh.a. nga Raiffeisen Zentralbank Österreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG.
3. Vendim nr.62, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e rregullave të funksionimit të sistemit IDBS”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 16, Gusht 2004

1. Vendim nr.66, datë 22.09.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2004”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 17, Nëntor 2004

1. Vendim nr.67, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.68, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”.